



SIPAS STATISTIKËS SË “TVSH-JA IME” QYTETARËVE DERI MË TANI U JANË KTHYER 7,3 MILIARDË DENARË.

Drejtoria e të Ardhurave Publike raporton se ka bërë pagesën e mjeteve nga “TVSH-ja ime” për tremujorin e dytë të këtij viti.

Tek qytetarët që skenuan llogaritë fiskale për muajt prill, maj dhe qershor u janë paguar 707.246.087,00 denarë. Në ditët në vijim do të bëhet pagesa për ata përdorues të aplikacionit që kanë bërë ndryshime në llogarinë e tyre të transaksionit.

Në këtë tremujor të dytë, 13.402 qytetarë janë përdorues të rinj të aplikacionit “TVSH-ja ime”.

Sipas analizave të Drejtorisë së të Ardhurave Publike, mbi 530 mijë qytetarë në muajt prill, maj dhe qershor kanë skenuar 86,9 milionë llogari fiskale me qarkullim prej 54,2 miliardë denarë..

Drejtoria e të Ardhurave Publike u apelon qytetarëve që janë përdorues të aplikacionit “TVSH-ja ime” që të fusin të dhëna të sakta për të kryer pagesën në kohë.

Arsyet më të shpeshta pse nuk kryhet pagesa janë: llogaria e transaksionit e futur gabimisht, llogaria e transaksionit të një personi tjetër dhe jo e përdoruesit të aplikacionit, ose është futur numri i kartës së pagesës në vend të numrit të llogarisë së transaksionit, një llogari që tashmë është mbyllur ose nuk është futur fare.

Projekti i “TVSH-ja ime”, të cilën Drejtoria e të Ardhurave Publike e ka nisur më 1 korrik 2019, po zbatohet me sukses dhe i arrin me sukses dy qëllimet kryesore: kthimin e parave tek qytetarët dhe shmangien e ekonomisë gri.

Nga 1 janari 2023, është rritur limiti për shumën më të lartë të rimbursimit për kthimin e një pjese të “TVSH-së” e shprehur në llogaritë fiskale për një tremujor për shfrytëzues nga 1800 denarë në 2100 denarë.

